



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.80/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. Protokolli 01/156/2026, të datës 31.01.2026, për shkak të mos publikimit të rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve për subjektin politik Lista Serbe dhe kandidatët e saj, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 03.02.2026, merr këtë:

V E N D I M

APROVOHET ankesa e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. Protokolli 01/156/2026, të datës 31.01.2026, NDRYSHOHET pika – III - e dispozitivit të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. Protokolli 01/156/2026, të datës 31.01.2026, ashtu që shpallet rezultati përfundimtar për subjektin politik Lista Serbe dhe kandidatët e saj, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 02.02.2026, PZAP ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, duke theksuar se më 31 janar 2026, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) mbajti mbledhje ku u diskutua për publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor 2025, dhe se në mbledhjen e përmendur u vendos që votimi për publikimin e rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve të zhvillohet individualisht për subjektet politike që morën pjesë në zgjedhje dhe morën vota nga qytetarët.

Tutje në ankesë parashtruesi thekson se me këtë rast, Komisioni Qendror Zgjedhor i ka dhënë vetes leje të ndajë subjektet politike megjithëse të gjithë morën pjesë në të njëjtin proces zgjedhor dhe në këtë mënyrë ka vënë në dyshim legjitimitetin e të gjithë procesit të votimit i cili duhet të ishte një proces demokratik dhe jo i politizuar.

Parashtruesi i ankesës thekson se mbi bazën e një veprimi të tillë, u fillua votimi dhe me këtë rast u mor Vendimi nr. 01-156/2026 me të cilin në pikën III konstatohet se refuzohet publikimi

i rezultateve përfundimtare të arritura nga subjekti ynë politik në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, duke diskriminuar në mënyrën më të drejtpërdrejtë subjektin tonë politik dhe duke mohuar 42459 vota të qytetarëve tanë, duke shkelur në mënyrën më të drejtpërdrejtë Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe rregullat zgjedhore. Vendimi për të mos publikuar rezultatet përfundimtare të subjektit tonë politik pa asnjë bazë dhe arsyetim ligjor, konfirmon qëndrimin tonë se është fjalë për një vendim politik dhe jo të bazuar ligjërisht. Po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se ky vendim i paligjshëm nuk është dërguar në email-in, zyrtar të Listës Serbe duke u mohuar kështu e drejta ligjore për ankim dhe duke shkelur nenin 109, të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L-031.

Gjithashtu në ankesë theksohet se është paradoksale dhe logjiksht e pashpjegueshme që në një proces zgjedhor të verifikohen rezultatet e subjekteve të tjerë politike, ndërsa rezultati i Listës Serbe të vihet në dyshim, pa asnjë dëshmi apo arsyetim për një vendim të tillë, dhe se me një vendim të tillë, Komisioni Qendror Zgjedhor ka rrezikuar të drejtat themelore të njeriut të qytetarëve dhe, në mënyrën më të drejtpërdrejtë nenin 45 dhe nenin 139 të Kushtetutës së Kosovës. Tutje në ankesë theksohet se me vendimin që me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit Qendror Zgjedhor të rrezikohen të drejtat themelore të njeriut, Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës, përfaqëson një sulm ndaj rendit ligjor duke vënë në dyshim punën e një prej institucioneve më të rëndësishme në Kosovë, por edhe duke minuar besimin e komunitetit serb në punën e institucioneve kosovare, respektimin e të drejtave të njeriut, të pakicave dhe politike, veçanërisht duke pasur parasysh shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të subjektit tonë politik i cili ka mbështetjen më të madhe bindëse të komunitetit serb, dhe se ne jemi të vetëdijshëm se një anëtar i ynë, nga 11 sa ka Komisioni Qendror Zgjedhor, nuk është në gjendje të parandalojë miratimin e vendimeve të paligjshme në dëm të Listës Serbe dhe të popullit serb. Kjo nuk e zvogëlon përgjegjësinë e drejtuesve të Komisionit Qendror Zgjedhor të cilët lejojnë një marrje vendimesh të vazhdueshme të paligjshme të tilla.

Pala ankuese propozon se mbi bazën e nenit 53 paragrafi 1, nenit 131 paragrafi 4 dhe nenit 132 paragrafi 5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në përputhje me nenet 118 dhe 119 të Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP) të miratojë një vendim me të cilin do ta vërë jashtë fuqisë ligjore vendimin e paligjshëm dhe jo kushtetues të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Pala ankuese propozon që të pranoj ankesën si të bazuar, të konstatoj se Vendimi nr. 01-156/2026 i datës 31.01.2026. është i paligjshëm dhe që të urdhëroj Komisionin Qendror Zgjedhor që të miratoj vendimin për publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare për subjektin politik "Lista Serbe" ose ta bëjë këtë në vend të tij. Ankesës i ka bashkangjitur Vendimin e KQZ-së nr. 01-156/2026 i datës 31.01.2026.

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 paragrafi 29, nenin 101 paragrafi 16, nenin 106 paragrafi 3, nenin 111 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore, pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), procesit të rinumërimit të të gjitha vendvotimeve të rregullta në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), fletëvotimeve nga votimi me kusht, fletëvotimet nga

votimi i personave me nevoja të veçanta dhe fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës, në QNR, në mbledhjen e rregullt numër dhjetë (10) të mbajtur me datën 31.01.2026, me vendimin Nr.01/156/2026 ka shpallur rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025. Ndërsa, lidhur me shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025, për subjektin politik "Srpska Lista" dhe kandidatëve të saj, nuk ka arritur të merr dy të tretat (2/3) e votave të KQZ-së, pasi që me rastin e votimit tri (3) vota ishin për, dy (2) kundër dhe gjashtë (6) abstenime dhe rrjedhimisht shpallja e rezultatit për këtë subjekt politik dhe kandidatët e saj është refuzuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli vlerësoi se në bazë të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankese nga KQZ, rezulton se KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.01.2026, nuk e ka miratuar shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, për subjektin politik Lista Serbe dhe kandidatëve të saj. Në arsyetimin e vendimit të marrë në këtë mbledhje thuhet se “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga qendrat e rregullta të votimit në qendrat komunale të numërimit (QKN), dhe procesit të rinumërimit të të gjitha qendrave të rregullta të votimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në përputhje me vendimin e KQZ-së të datës 19.01.2026, fletëvotimeve nga votimi me kusht, fletëvotimeve nga votimi për personat me nevoja të veçanta dhe fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), shpall rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025, si në pikën I të këtij vendimi. Ndërkohë, publikimi i rezultateve përfundimtare për partinë politike, Listën Serbe dhe kandidatët e saj, nuk mori dy të tretat (2/3) e votave të KQZ-së, pasi që me rastin e votimit tri (3) vota ishin për, dy (2) kundër dhe gjashtë (6) abstenime dhe rrjedhimisht shpallja e rezultatit për këtë subjekt politik dhe kandidatët e saj është refuzuar”.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe arsyetimit të KQZ-së të përmbajtur në vendimin e ankimuar të datës 31.01.2026, me numër protokolli Nr.01/156/2026, vlerëson se një qëndrim i tillë nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, pasi është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme LZP, nenin 101 paragrafi 16, nenin 106 paragrafi 3, nenin 111 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) nuk pajtohet me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për mos shpalljen e rezultatit përfundimtar për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, për subjektin politik Lista Serbe dhe kandidatët e saj. PZAP vlerëson se ky vendim është i pajustificuar dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të sipër cekura, kjo për faktin se duke pas parasysh se kanë përfunduar të gjitha procedurat e numërimit dhe rinumërimit për të

gjitha subjektet politike, rezultati përfundimtar duhet të shpallet menjëherë dhe të përfshijë të gjitha subjektet zgjedhore pa përjashtim. Çdo shpallje e pjesshme e rezultatit përfundimtar, në rrethana të tilla, nuk ka bazë ligjore dhe bie ndesh me parimet e barazisë së subjekteve zgjedhore, sigurisë juridike dhe transparencës së procesit zgjedhor. Andaj ky vendim është në kundërshtim me praktikën e mira zgjedhore dhe po ashtu në kundërshtim me standardet e Komisionit të Venecias.

Nga shqyrtimi i vendimit të ankimuar, PZAP konstaton se KQZ nuk ka ofruar asnjë arsytim ligjor për refuzimin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 28 Dhjetor 2025, për subjektin politik Lista Serbe dhe kandidatët e saj. Vendimi i KQZ-së është i mangët, jo i plotë dhe nuk i ka trajtuar çështjet thelbësore as faktet vendimtare që lidhen me vlerësimin e kushteve ligjore për shpalljen e rezultatit të përfundimtar. Në mungesë të një arsytimi të mirëfilltë ligjor, vendimi si i tillë nuk përmban as vlerësimin e duhur të fakteve në raport me dispozitat ligjore të LZP-së, dhe me Rregulloren nr.13/2024 rezultatet zgjedhore.

Andaj, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, konform nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh se: *“Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.”* Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, PZAP-i, ka vendosur të aprovojë ankesën e subjektit politik Lista Serbe, duke shpallur rezultatin përfundimtar për këtë subjekt politik dhe kandidatët e saj. Në këtë mënyrë, vendimi në fjalë siguron respektimin e procedurave ligjore dhe garanton zhvillimin e një procesi të drejtë dhe të barabartë për subjektin politik që ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara me ligj.

Në pajtim me nenin 115 par. 1 nenin 118 par. 1 dhe 5 nenin 106 LZP-së, si dhe nenit 13 par.2 të Rregullores nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP.A.nr.80/2026, datë 03.02.2026



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.